




PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL SHQIPËRI

Thirrje për Aplikime për Skemën e Granteve në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti

20 Korrik 2020

Një projekt i:



Ky projekt zbatohet nga:



Në bashkëpunim me:



Tabela e Përmbajtjes

1	Informacion i përgjithshëm mbi Skemën e Granteve të PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti	4
1.1	Përshkrimi dhe përjasja	4
1.2	Strukturat drejtuese	5
1.3	Alokimi financiar i mundësuar nga Donatorët	5
1.4	Përzgjedhja e projekteve, akordimi i grantit dhe pagesa e fondeve të grantit.....	6
2	Rregullat e Skemës së Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti.....	7
2.1	Kriteret e lejueshmërisë	7
2.1.1	Kriteret për aplikantët (aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikanti (ët))	7
2.1.2	Projektet e Lejuara: Projektet për të cilat mund të bëhet një aplikim	8
2.1.3	Lejueshmëria e kostove: kostot që mund të mbulohen nga një grant	12
2.2	Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur.....	12
2.2.1	Aplikimi	12
2.2.2	Ku dhe si t'i dërgoni aplikimet.....	13
2.2.3	Afati për dorëzimin e aplikimeve	13
2.2.4	Informacion i mëtejshëm rreth aplikimeve	14
2.3	Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekt-propozimeve.....	14
2.4	Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues	16
2.4.1	Përmbajtja e vendimit	16
2.4.2	Paraqitja e dokumenteve shoqëruese për aplikimet e përzgjedhura përkohësisht.....	17
2.5	Afate indikative	17
2.6	Firmosja e kontratës së Grantit.....	18
2.7	Kushtet e zbatimit pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për akordimin e një granti.....	18
3	LISTA E SHTOJCAVE.....	18

Lista e akronimeve

ADA	Agjencia Austriake e Zhvillimit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
PZHRSH	Programi për Zhvillimin Rajonal Shqipëri, Faza IV
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNPF	Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë

1 Informacion i përgjithshëm mbi Skemën e Granteve të PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti

1.1 Përshkrimi dhe përjasja

Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri Faza IV, 2019-2023 ('PZHRSH' ose 'Programi'), është një projekt i financuar bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) (Donatorët), i zbatuar në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare. Qëllimi kryesor i Programit është inkurajimi i një zhvillimi shoqëror dhe ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm duke u mbështetur në karakteristikat dhe atributet e rajoneve, duke ruajtur dhe zhvilluar karakteristikat e tyre natyrore dhe kulturore, si dhe inkurajuar zhvillimin ekonomik me synimin e reduktimit të pabarazive në Shqipëri dhe sigurimit të kushteve më të mira sociale dhe ekonomike për qytetarët shqiptarë.

Programi i cili zbatohet në përputhje me marrëveshjen dypalëshe midis Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, synon të rrisë kohezionin rajonal, të zvogëlojë pabarazitë në përdorimin e burimeve, të rrisë produktivitetin dhe standardet sociale/mjedisore, duke ofruar gjithashtu mbështetje të drejtpërdrejtë financiare në formën e granteve për autoritetet lokale, pasi këto të fundit janë aktorët aktivë në terren.

Vetëm disa muaj më parë, në vjeshtën e vitit 2019, Shqipëria, dhe më së shumti, rajoni Tiranë-Durrës u godit nga dy tërmete të magnitudës së lartë, 5.7 të shkallës Rihter në Shtator dhe 6.3 të shkallës Rihter në Nëntor, duke shkaktuar dëme të mëdha në të paktën 11 nga 61 bashkitë e vendit, përfshirë dy bashkitë më të populluara, të urbanizuara dhe të zhvilluara (Tirana dhe Durrësi). Bashkitë më të prekura janë: Shijak, Durrës, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë. Si rezultat i fatkeqësisë, gjithsej në vend u prekën 202,291 njerëz, 47.263 në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe 155.029 jo të drejtpërdrejtë.

Qeveria e Shqipërisë kërkoi mbështetje nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore për të ndërmarrë një Vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të Nevojave Pas Fatkeqësisë (VNPF) të fokusuar në bashkitë më të prekura, për të identifikuar dëmet, humbjet dhe nevojat e rimëkëmbjes si rrjedhojë e tërmetit. Strategjia kombëtare e rimëkëmbjes nënvizon faktin se rimëkëmbja realizohet më së miri në nivelin lokal, ku asistencë në formën e financimeve, fuqisë punëtore dhe informacionit nga burime të jashtme dhe nga nivele më të larta të qeverisë është jetike.

Skema e granteve të PZHRSH-së në mbështetje të zonave të prekura nga tërmeti është iniciativë e SDC dhe ADA si përgjigje dhe adresim të nevojave të pushtetit lokal në situatën e krijuar pas tërmetit të Nëntorit me **objektivin e përgjithshëm të mbështesë të gjithë komunitetet dhe njësitë e qeverisjes lokale të prekura direkt nga tërmeti të adresojnë sfidat¹ zhvillimore komplekse të rimëkëmbjes në territoret e tyre bazuar në potencialet e identifikuar duke ndjekur orientimet strategjike të planit të rimëkëmbjes.**

Objektivi specifik i skemës së granteve PZHRSH është të mbështesë ndërhyrjet e rehabilitimit dhe rindërtimit, veçanërisht në bashkitë më të prekura: Shijak, Durrës, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë, në përputhje me fushat e ndërhyrjes së skemës siç renditen në seksionin 2.1.2.

Më shumë informacion mbi Programin dhe Skemën e Granteve mund të gjeni në faqen e internetit: www.rdpa.al.

¹ Qeveria e Shqipërisë ka përgatitur dhe miratuar tashmë një Program Rindërtimi si pjesë e Buxhetit 2020, që konsiston në 100 milionë Euro burime vendase dhe 70 milion (+) donacione. Programi është ndarë në 5 nën-programe: (i) ndërtimi i ndërtesave të reja dhe njësitë të veçanta të banimit; (ii) rimëkëmbja e ndërtesave ekzistuese përmes granteve; (iii) fondi i strehimit social; (iv) rindërtimi i objekteve publike dhe infrastrukturës; (v) masat e rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike. Në vijim, janë miratuar 25 kantieri ndërtimi prej gjithsej 300 ha me plane detyruese të rindërtimit dhe janë hapur procedurat e tenderit për nisjen e ndërtimit. Shumica e veprimeve të parashikuara për t'u adresuar në planin e rimëkëmbjes do të merren me ndërtimin ose rindërtimin e njësitë të strehimit, objekteve dhe infrastrukturës (arsimore, shëndetësore, kulturore, sociale në disa raste, ndërtesa publike qeveritare, etj.)

1.2 Strukturat drejtuese

Autoriteti Kontraktues

Fondacioni PZHRSH do të jetë Autoriteti Kontraktues për Skemën e Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti. Në këtë cilësi, Fondacioni PZHRSH do të nënshkruajë kontratat e granteve me Përfituesit e skemës së grantit dhe do të menaxhojë disbursimin e fondeve përgjatë gjithë zbatimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse kontraktuale. Fondacioni në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit do të sigurojë që Skema e Granteve RDPA të zbatohet dhe fondet të disbursohen, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar.

Enti i Deleguar

Në mënyrë që Skema e Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti të zbatohet me efektivitet dhe efikasitet, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë Enti i Deleguar dhe, ndërmjet të tjerave, do të:

- Informojë aplikantët për kushtet e financimit;
- Marr dhe të regjistrojë aplikimet;
- Krijojë Komisionin e Vlerësimit që do të kryejë përzgjedhjen e projekteve në përputhje me kushtet dhe kriteret e publikuara në Thirrjen për Aplikime;
- Mbështesë Autoritetin Kontraktues për finalizimin e kontratave të grantit për projektet e përzgjedhura;
- Udhëzojë përfituesit e granteve si dhe t'i mbështesë ata me përgatitjen e dosjeve të prokurimit publik dhe të tenderimit kurdo që të jetë e përshtatshme;
- Kryejë verifikimet e menaxhimit, miratimet për pagesat dhe/ose rimbursimet e shpenzimeve të grantit;
- Sigurojë monitorimin dhe raportimin mbi Skemën e Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti;
- Sigurojnë vizibilitetin e Skemës së Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti.

Rrjedhimisht, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të luajë një rol kyç si në përzgjedhjen ashtu edhe në zbatimin e projekteve.

Komisioni i Vlerësimit

Komisioni i Vlerësimit do të krijohet nga FSHZH në mënyrë që të vlerësojë dhe të përzgjedhë projekt-propozimet. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit do të garantojnë vlerësimin e tyre profesional, të paanshëm dhe konfidencial të projekt-propozimeve. Komisioni i Vlerësimit mund të mbështetet nga ekspertizë teknike e jashtme e paanshme.

1.3 Alokimi financiar i mundësuar nga Donatorët

Shuma e përgjithshme e mundësuar përmes kësaj Thirrjeje për Aplikime është 248,280,000 LEKË² pa TVSH. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjithë fondet në dispozicion.

Vlera e granteve

Secili grant i kërkuar në këtë thirrjeje për aplikime duhet të jetë midis vlerave të mëposhtme minimale dhe maksimale, pa TVSH:

Vlera minimale e grantit	Vlera maksimale e grantit
7,448,000 LEKË	43,449,000 LEKË

² Fondi i skemë së granteve, shumat minimale dhe maksimale e granteve u miratua në EUR nga Komiteti Drejtues i Projektit. Shumat e mësipërme janë ekuivalente me miratimin e konvertuar bazuar në kursin e këmbimit të Korrikut (muaji kur lançohet thirrja) siç është botuar në InforEuro të Komisionit Evropian¹ EUR = 124.14 ALL.

Kostot e lejuara të projekteve sipas kësaj thirrjeje do të mbulohen 80% kurdo që shuma e projektit është midis vlerës minimale dhe maksimale të grantit.

TVSH-ja e projekteve është klasifikuar si kosto e palejueshme dhe do të mbulohet nga përfituesit.


Në rastet kur Aplikanti aplikon për grantin për të financuar një projekt me një vlerë më të lartë sesa vlera maksimale e grantit, përqindja e kostove të projektit që do të mbulohen nga granti do të llogaritet bazuar në shumën e kostove totale të lejuara të projektit.

1.4 Përzgjedhja e projekteve, akordimi i grantit dhe pagesa e fondeve të grantit

Skema e Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti do të zbatohet përmes 10 hapave. Në Figurën 1, janë paraqitur përgjegjësitë dhe koha indikative për secilin hap.

Kontrata e grantit do të përcaktojë përgjegjësitë e detajuara të Autoritetit Kontraktues dhe të Entit të Deleguar.

Figura 1. Hapat, përgjegjësitë dhe koha indikative në Skemën e Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti



2 Rregullat e Skemës së Granteve PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti

2.1 Kriteret e lejueshmërisë

Kemi tri nivele të kriterëve të lejueshmërisë, që lidhen me:

(1) Aktorët:

- Aplikanti kryesor, dmth. entiteti që paraqet formularin e aplikimit (shih seksionin 2.1.1 më poshtë),
- nëse ka, bashkë-aplikanti(ët) (nëse nuk specifikohet ndryshe aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikant(ët), referohen në vijim bashkërisht si “aplikant(ët)”) (shih seksionin 2.1.1 më poshtë),

(2) Projektet:

- Projektet për të cilat mund të akordohet një grant (shih seksionin 2.1.2 më poshtë);

(3) Kostot:

- Llojet e kostove që llogariten për të përcaktuar shumën e grantit (shih seksionin 2.1.3 më poshtë).

2.1.1 Kriteret për aplikantët (aplikanti kryesor dhe bashkë-aplikanti (ët))

Aplikanti kryesor

(1) Në mënyrë që të jetë i pranueshëm për një grant, aplikanti kryesor duhet:

- të jetë një nga këto bashki të Shqipërisë: Shijak, Durrës, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë;
- të jetë operacional në zonën gjeografike ku do të zbatohet projekti;
- të jetë direkt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e aktiviteteve, jo të veprojë si një ndërmjetës.

(2) Nëse nuk ka bashkë-aplikant, atëherë aplikanti kryesor do të përkufizohet si përfitues i Kontratës së Grantit. Në rast të bashkë-aplikantit(ve), këta do të emërtohen partner(ë) zbatues pas akordimit të grantit, ndërsa përfituesi (aplikanti kryesor) do të identifikohet në Kontratën e Grantit si Koordinator.

(3) Aplikanti kryesor do të menaxhojë fondet e Grantit dhe transfertat e fondeve drejt bashkë-aplikantit(ve), në linjë me aktivitetet dhe kostot e parashikuara.

Bashkë-aplikanti(ët)

Bashkitë në territoret e lejuara mund të aplikojnë individualisht apo së bashku me një tjetër Bashki. Në këtë rast, një bashki do të jetë aplikanti kryesor dhe tjetra do të jetë bashkë-aplikanti (ët). Kriteret e lejueshmërisë që aplikohen për bashkë-aplikantit janë si më poshtë:

- të jetë një nga këto bashki të Shqipërisë: Shijak, Durrës, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë;
- të jetë operacional në zonën gjeografike ku do të zbatohet projekti;
- të jetë direkt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e aktiviteteve me aplikantit kryesor.

Bashkë-aplikantët marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e Projektit, dhe kostot e tyre në kuadër të zbatimit të Projektit janë njësoj të lejueshme si dhe kostot e aplikantit kryesor.

Sipas Skemës së Granteve të PZHRSH në Mbështetje të Zonave të Prekura nga Tërmeti, një Bashki mund të paraqesë më shumë se një projekt-propozim brenda kufirit maksimal të grantit.

Një Bashki gjithashtu mund të aplikojë bashkërisht me një ose më shumë Bashki. Në rast se një Bashki aplikon së bashku me një ose më shumë Bashki, me kushtin që një Bashki tjetër të jetë aplikant kryesor, pjesa e buxhetit respektiv të bashkisë - bashkë-aplikante do të përbëjë një pjesë të shumës maksimale prej 43,449,000 LEKË.

Kontrata e grantit do të nënshkruhet vetëm nga aplikanti kryesor.

2.1.2 Projektet e Lejuara: Projektet për të cilat mund të bëhet një aplikim

Përkufizim

Një Projekt përbëhet nga një grup aktivitete.

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e një Projekti nuk mund të tejkalojë **1 vit dhe 3 muaj** – nga firmosja e kontratës tek paraqitja e raportit përfundimtar përshkrues dhe financiar.

Vendndodhja

Projektet duhet të zbatohen në territorin e bashkive: Shijak, Durrës, Krujë, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Kurbin, Mirditë dhe Lezhë.

Llojet e Projekteve

Llojet e Projekteve të cilat mund të financohen nëpërmjet kësaj thirrjeje:

- (1) Ndërhyrjet në infrastrukturën lokale arsimore për rimëkëmbjen dhe përmirësimin e kushteve për shërbimet dhe strukturat arsimore.
- (2) Ndërhyrjet në turizëm, infrastrukturën artistike dhe të trashëgimisë kulturore për të rimëkëmbur dhe përmirësuar turizmin dhe jetën kulturore në qytete.
- (3) Ndërhyrjet në infrastrukturën ekonomike për rimëkëmbjen dhe përmirësimin e kushteve të duhura për aktivitetet ekonomike lokale.
- (4) Ndërhyrjet në infrastrukturën sociale për të rimëkëmbur dhe përmirësuar kushtet për shërbimet sociale, promovimin e përfshirjes sociale, për të luftuar varfërinë dhe diskriminimin.
- (5) Ndërhyrjet në rimëkëmbjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së lëvizshmërisë dhe transportit për të lehtësuar aksesin në transportin publik.
- (6) Ndërhyrjet në infrastrukturen komunitare për ofrimin e cilësisë së jetës në komunitetet lokale, të tilla si rehabilitimi dhe krijimi, rigjenerimi dhe krijimi i zonave rekreative publike; ndërtimi/rindërtimi/rehabilitimi i hapësirave publike, etj.;
- (7) Ndërhyrjet në infrastrukturën e biznesit për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike dhe zhvillimin e nën-sektorëve të tillë si turizmi dhe mikpritja, si dhe agrobiznesi.
- (8) Masa të lehta ndërhyrjeje (jo infrastrukturore) në mbështetje të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, si për autoritetet lokale ashtu edhe bizneset; mbështetje për grupet e marginalizuara dhe femrat sipërmarrëse.

Duke ju referuar Projekteve të lejueshme, më poshtë janë listuar disa shembuj të aktiviteteve të lejuara për secilën tipologji:

(1) Ndërhyrjet në infrastrukturën lokale arsimore për rimëkëmbjen dhe përmirësimin e kushteve për shërbimet dhe strukturat arsimore.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Ndërtimi, rikonstruksioni, modernizmi dhe rinovimi i institucioneve arsimore bashkiake, të tilla si çerdhet dhe kopshtet, shkollat e mesme dhe nëntëvjeçare (klasat mësimore, bibliotekat, laboratorët e shkollave, ambientet sportive, hapësirat e shkollave, konviktet, lidhja me internet) duke përfshirë edhe oborret shkollore përkatëse nëse ka;
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve dhe orendive për ndërtesat dhe ambientet e listuara më sipër, si edhe pajisjet ndihmëse, si pjesë e përmirësimit të tyre të përgjithshëm;
- Përmirësimi i aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara në ndërtesat e përmendura më sipër.

(2) Ndërhyrjet në turizëm, infrastrukturën artistike dhe të trashëgimisë kulturore për të rimëkëmbur dhe përmirësuar turizmin dhe jetën kulturore në qytete.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Grup aktiviteteve për "Turizëm" - Ndërtimi, rikonstruksioni, rinovimi, pajisja dhe mobilimi i infrastrukturës dhe/ose zonave me pajisje specifike për turizëm, përfshirë agriturizmin;
- Grup aktiviteteve për "Trashëgiminë artistike dhe kulturore" - Zhvillimi i infrastrukturës në fushën artistike dhe kulturore përmes ndërtimit, rikonstruksionit, rinovimit, pajisjes dhe mobilimit të qendrave kulturore, qendrave komunitare, bibliotekave, sallave të ekspozitave dhe institucioneve të tjera kulturore, duke përfshirë edhe oborret përkatëse nëse ka;
- Përmirësimi i aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara në ndërtesat e përmendura më sipër;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe historike nëpërmjet teknikave inovative.

(3) Ndërhyrjet në infrastrukturën ekonomike për rimëkëmbjen dhe përmirësimin e kushteve të duhura për aktivitetet ekonomike lokale

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Rinovimi / rikonstruksioni / ndërtimi i përgjithshëm i infrastrukturës ekonomike lokale për ofrimin e lehtësirave të përshtatshme në mbështetje të aktiviteteve ekonomike, start-up etj
- Ndërtimi, riparimi, rikonstruksioni, i rrugëve që kanë ndikim direkt në përmirësimin e aksesit në treg për bizneset lokale;
- Ndërtimi, riparimi dhe / ose rikonstruksioni i inkubatorëve të biznesit që do të lehtësojnë aktivitetet ekonomike lokale.

(4) Ndërhyrjet në infrastrukturën sociale për të rimëkëmbur dhe përmirësuar kushtet për shërbimet sociale, promovimin e përfshirjes sociale, për të luftuar varfërinë dhe diskriminimin

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Rinovimi / rikonstruksioni/ ndërtimi i përgjithshëm i infrastrukturës së përshtatshme bashkiake për ofrimin e shërbimeve komunitare për të moshuarit, fëmijët dhe njerëzit me aftësi ndryshe: i qendrave të kujdesit ditor, qendrave të strehimit, qendrave të asistencës për krizat, strehave sociale, etj, përfshirë edhe oborret përkatëse nëse ka;

- Ndërtimi, riparimi, rikonstruksioni, rinovimi i ndërtesave për shtëpitë e mbrojtura (zgjerimi, rikonstruksioni dhe ristrukturimi i hapësirave), duke përfshirë edhe oborrin përkatës;
- Dorëzimi dhe montimi i pajisjeve dhe orendive për ndërtesat dhe godinat e listuara më sipër, si edhe pajisjet ndihmëse, si pjesë e rregullimit të tyre të përgjithshëm;
- Përmirësimi i aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara në ndërtesat e përmendura më sipër.

(5) Ndërhjert në rimëkëmbjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së lëvizshmërisë dhe transportit për të lehtësuar aksesin në transportin publik.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Rimëkëmbja dhe përmirësimi i infrastrukturës bazë dhe aksesit për në stacionet e autobusit; – platformat e ndalesave për grupet me aftësi të kufizuara; orientimi dhe informimi; lajmërimi i ndalesave me ndriçim dhe audio; vijëzim i qartë vizual për vijat dhe tabelat me oraret të lexueshme për ata që shikojnë me vështirësi, etj.;
- Rikonstruksioni/rehabilitimi i korsisë për këmbësorët dhe trotuaret, ndërtimi i korsive dhe rrugicave për biçikletat, zonat e këmbësorëve, rrugicat për këmbësorët dhe çiklistët, duke përfshirë aktivitetet që lidhen me to si vendosja e tabelave treguese, shenjimi, etj. si pjesë e një sistemi të transportit urban të integruar;
- Rikonstruksioni/rehabilitimi i lidhur me organizimin e parkimit në afërsi të nyjeve të rëndësishme të transportit publik urban, si për mjetet motorike edhe biçikletat;
- Zhvillimi/ rikonstruksioni/rehabilitimi i infrastrukturës së transportit publik për destinacionet e reja në drejtim të zonave të largëta rezidenciale;
- Përmirësimi i aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara për sa u përmend më lart.

(6) Ndërhjert në infrastrukturen komunitare për ofrimin e cilësisë së jetës në komunitetet lokale, të tilla si rehabilitimi dhe krijimi, rigjenerimi dhe krijimi i zonave rekreative publike; ndërtimi /rindërtimi /rehabilitimi i hapësirave publike, etj.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Rehabilitimi dhe krijimi, rigjenerimi dhe krijimi i zonave rekreative për publikun, p.sh. parqe, këndet e lojrave për fëmijë etj.;
- Përmirësimi i mjedisit urban nëpërmjet vendosjes së stolave, strehave, shatërvanëve, statujave, etj.;
- Ndërtimi/ rikonstruksioni/ rehabilitimi i vendkalimeve për kalimtarët dhe rinovimi i trotuareve, përmirësimi i aksesit për njerëzit me aftësi të kufizuara; ndërtimi i rrugëve dhe rrugicave për çiklistët, zonat e këmbësorëve, rrugicat dhe nënkalimet për këmbësorët dhe çiklistët, përfshirë edhe ndërhjertet e lidhura me to të tilla si sinjalistika, etj.;
- Lehtësirat për aksesin në ndërtesat administrative bashkiake për njerëzit me aftësi të kufizuara.

(7) Ndërhjert në infrastrukturën e biznesit për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike dhe zhvillimin e nën-sektorëve të tillë si turizmi dhe mikpritja, si dhe agrobiznesi.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

- Turizmi dhe mikpritja p.sh: krijimi i platformave për bashkëpunim të operatorëve turistikë dhe bizneseve të sektorit për informimin e turistëve dhe grupeve të interesit për të rritur numrin e turistëve/ platformave për një koncept të integruar të turizmit;

- Agrobiznesi p.sh: lehtësimi i aksesit në treg, duke përfshirë konsulencat teknike dhe menaxhuese, hartimi dhe zbatimi i fushatave të marketingut, hulumtimi i tregut, kontrolli dhe çertifikimi i cilësisë, rritja e produktivitetit, proceset e prodhimit dhe dizenjimit të produktit, organizimi i panairove etj.;
- Fusha të tjera që autoritetet lokale mund t'i ofrojnë sektorit privat në lidhje me infrastrukturën e rimëkëmbjes së biznesit duke pranuar që kjo e fundit përfshin jo vetëm investime fizike, por edhe softuerë bazikë, mund të jenë instalimi i teknologjive të informacionit, sistemeve operative, platformave informatike, mjeteve të komunikimit dhe platformave të menaxhimit të përmbajtjes në gjendje që t'i ofrojnë sektorit privat faqe interneti dhe sisteme të rimëkëmbjes nga fatkeqësia.

(8) Masa të lehta ndërhyrjeje (jo infrastrukturore) në mbështetje të rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, si për autoritetet lokale ashtu edhe bizneset; mbështetje për grupet e marginalizuara dhe femrat sipërmarrëse.

Shembuj të aktiviteteve të lejuara:

Përmirësimi i kapaciteteve të BNJ në autoritetet lokale për:

- Hartimin e inventareve dhe studimeve të fizibilitetit për infrastrukturën lokale (të lidhura me turizmin, agrobiznesin, transportin);
- Hartimin e studimeve të fizibilitetit për zhvillimin e komunitetit bazuar në përdorimin e energjisë së rinovueshme në strehim dhe turizëm;
- Përgatitjen e propozimeve për amendimin e kuadrit rregullator për dizajnimin dhe ndërtimin e ndërtesave publike dhe lehtësirave rrugore për sigurinë teknike gjatë tërmeteve;
- Inspektimin e ndërtesave publike dhe lehtësirave të transportit publik për funksionalitetin e ndërtimit dhe sigurinë;
- Përgatitja e një analize të kushteve (gjendjes) dhe metodologjisë për inspektimin e funksionalitetit dhe sigurisë së ndërtesave publike dhe lehtësirave të infrastrukturës së transportit.

Përmirësimi i kapaciteteve të BNJ për bizneset:

- Nëpërmjet ekspertizës së jashtme (konsulentëve), p.sh. se si të sigurohet vazhdimësia e biznesit duke ofruar këshilla të specializuara bizneseve për rikuperimin dhe ndërtimin e një modeli të rimëkëmbjes së biznesit për të ardhmen;
- Mbështetje në fushat kryesore të biznesit (menaxhimi i cilësisë, marketing dhe hulumtim) për sektorët kryesorë të mikrobiznesit (bujqësia, hortikultura, turizmi, etj.) përmes qendrave të biznesit të sponsorizuara nga fonde publike;
- Mbështetje për grupet e marginalizuara dhe gratë sipërmarrëse që operojnë në (por jo vetëm) p.sh. në bizneset e artit dhe artizanatit, që të bëhen përsëri funksionale përmes konsultimeve teknike dhe menaxhuese, hartimit dhe zbatimit të fushatave të marketingut, planifikimit të biznesit, rritjes së produktivitetit, organizimit të panairove etj.

Aplikantëve u rekomandohet të kontrollojnë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit lejueshmërinë e aktiviteteve specifike të ndryshme nga sa listuar më lart.

Projektet që nuk lejohen

Projektet e pjesshme apo projekte të cilat kanë filluar tashmë nuk janë të lejueshme. Projektet e financuara nga granti nuk duhen të varen nga financime të tjera të tilla si hua ose grante potenciale.

2.1.3 Lejueshmëria e kostove: kostot që mund të mbulohen nga një grant

Vetëm kostot e lejuara do të mbulohen nga grantet e PZHRSH-së. Kategoritë e lejueshme dhe të palejueshme të kostove janë të listuara më poshtë. Buxheti është njëkohësisht një vlerësim dhe një tavan për 'kostot e lejueshme'. Rimbursimi i kostove të lejueshme do të bazohet në kostot aktuale të kryera nga përfituesi dhe partneri i lejueshëm i përfituesit.

Kostot e lejuara

Kostot e mëposhtme janë të lejueshme:

- Punimet për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e infrastrukturës fizike që është në pronësi të përfituesit ose mirëmbajtja e të cilës është përgjegjësi e përfituesit;
- Blerja e pajisjeve, mobiljeve dhe furnizimeve që janë ndihmëse për punimet e lartpërmendura;
- Furnizimi me pajisje teknike dhe infrastrukturë IT;
- Shërbime konsulence;
- Kostot për vizibilitetin dhe eventet e vizibilitetit për aktivitetet e financuara;
- Shërbimet për mbikqyrjen e punimeve;
- Tarifat bankare.

Kostot e tilla janë të lejueshme nëse janë kryer dhe faturuar brenda periudhës së zbatimit të kontratës së grantit.

Kostot që nuk lejohen

Kostot e mëposhtme nuk janë të lejueshme:

- Pagat dhe kosto të tjera operacionale të Bashkive;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzime të kryera përpara firmosjes të kontratës së grantit;
- Kosto për përgatitjen e Projektit;
- Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- Dispozitat për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- Kosto të deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një tjetër Projekt nën një tjetër burim financimi;
- Blerje e tokës ose ndërtesave;
- Qera nga asetet;
- Kredi ndaj palëve të treta;
- TVSH-ja.

2.2 Si të aplikoni dhe procedurat që duhen ndjekur

2.2.1 Aplikimi

Aplikimet duhen dorëzuar në përputhje me udhëzimet e formularit të aplikimit për grantin, kuadrin logjik/matricen e aktiviteteve, si dhe buxhetin shtojca të këtyre udhëzimeve (Shtojca A, A1 dhe B). Aplikantët duhet të aplikojnë në gjuhën shqipe. Gjithsesi, pjesa "Përmbledhja Ekzekutive e Projektit" duhet të jetë si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze.

Çdo gabim apo mospërputhshmëri madhore në aplikim, për shembull, nëse shumat në tabelat e buxhetit janë të papajtueshme (kontradiktore), mund të çojnë në skualifikim të aplikimit.

Sqarime do të kërkohen vetëm kur informacioni i ofruar është i paqartë dhe si rrjedhojë pengon Entin e Deleguar dhe Autoritetin Kontraktues që të kryejnë një vlerësim objektiv.

Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Ju lutemi, vini re se do të vlerësohet vetëm aplikimi për grantin i hartuar duke plotësuar formularët e publikuar të aplikimit dhe të buxhetit. Prandaj, është e një rëndësie shumë të madhe që këto dokumente të përmbajnë TË GJITHË informacionin e nevojshëm sa i përket Projektit. Nuk duhet dërguar asnjë shtojcë shtesë, përveç atyre të kërkuara.

2.2.2 Ku dhe si t'i dërgoni aplikimet

Të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë 1(një) aplikim origjinal të firmosur dhe 2 (dy) kopje në formatin A4 secila e kapur veçmas. Aplikimi i plotë duhet të dërgohet edhe në formatin elektronik (me CD-ROM ose USB) në një file të vetëm (dmth. aplikimi nuk duhet ndarë në disa file të ndryshme), bashkë me file-n që përmban buxhetin dhe anekset e kërkuara. Dokumentet elektronike duhet të përmbajnë saktësisht të njëjtin aplikim si varianti në letër i mbyllur në zarf. Që të trija kopjet në letër dhe CD-ROM apo USB-ja duhet të vendosen në një zarf të vetëm të mbyllur.

Lista e kontrollit (seksioni 5 i formularit të aplikimit për grantin) dhe deklarata nga aplikanti kryesor, e firmosur sipas rregullit nga përfaqësuesi ligjor i bashkisë, (seksioni 6 i formularit të aplikimit për grantin) duhet të kapen në mënyrë të veçuar dhe të përfshihen në zarf.

Zarfi duhet të ketë të shkruar titullin e thirrjes për aplikime "CFP RDPA IV", emrin e plotë dhe adresën e aplikantit kryesor dhe fjalët "Not to be opened before the opening session" dhe "Të mos hapet deri në afatin e përcaktuar".

Bashkitë duhet t'i dërgojnë aplikimet e tyre pranë FSHZH-së. Aplikimet duhen dorëzuar me anë të postës, ose dorazi. Në rastin e dorëzimit dorazi, një mandat pranimi i firmosur dhe me datë do t'i jepet dorëzuesit. Aplikimet e dërguara me ndonjë mënyrë tjetër (psh. me faks ose me e-mail) ose të dorëzuara në adresa të tjera nuk do të pranohen. Adresa postare e FSHZH-së, si dhe orari i punës, është i shënuar më poshtë.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Adresa: Rruga "Sami Frasheri", Nr 10 Tiranë – Albania

Orari i punës: E Hënë – E Enjte 08.00 – 17.00, E Premte 08.00 – 14.00

Aplikantit kryesorë duhet të verifikojnë që aplikimi i tyre është i plotë duke përdorur listën e kontrollit (seksioni 5 i formularit të aplikimit për grantin). Aplikimet e paplota do të skualifikohen.

2.2.3 Afati për dorëzimin e aplikimeve

Afati për dorëzimin e aplikimeve është **21 Shtator 2020, ora 16.00** siç evidentohet nga data e postimit, nga vula postare ose nga data e mandatit të depozitimit.

Në rastin e dorëzimeve dorazi, afati përfundimtar për dorëzimin është përpara orës **16:00 me orën lokale** siç evidentohet nga mandati me datë dhe i firmosur. Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit përfundimtar do të skualifikohet automatikisht.

Autoriteti Kontraktues mund të skualifikojë aplikimet e dërguara në kohën e duhur, por që mbërrijnë pas afatit të aplikimit si rrjedhojë e vonesave postare. Për këtë arsye aplikantët nxiten të dorëzojnë aplikimin e tyre dorazi.

2.2.4 Informacion i mëtejshëm rreth aplikimeve

Pyetjet mund të dërgohen me e-mail jo më vonë se 30 ditë përpara afatit të dorëzimit të aplikimeve, **19 Gusht 2020**, në adresën e mëposhtme, duke shënuar qartësisht se i referohen e thirrjes për aplikime ‘CFP RDPA IV’:

Adresa e-mail: rdpa@rdpa.al

Autoriteti Kontraktues nuk ka detyrim të japë sqarime ndaj pyetjeve të marra pas kësaj date.

Për të mundësuar trajtimin e barabartë të aplikantëve, Autoriteti Kontraktues nuk do të sqarojë individualisht aplikantët mbi kriteret e aplikantëve kryesorë, bashkë-aplikantëve, një projekti apo aktivitetet specifike. Pyetjet që mund të jenë me rëndësi për aplikantët e tjerë, bashkë me përgjigjet, do të publikohen në faqen e internetit të PZHRSH: www.rdpa.al dhe faqen e internetit të FSHZH: www.albaniandf.org, sipas nevojave. Prandaj, është e këshillueshme të konsultoheni rregullisht me faqet e internetit të lartpërmendura në mënyrë që të merrni informacion për pyetjet dhe përgjigjet e publikuara.

2.3 Vlerësimi dhe përzgjedhja e projekt-propozimeve

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të realizohet në katër faza:

Faza 1: Kontrollat për lejueshmërinë (kriteret)

Kjo fazë do të përfshijë verifikimin e lejueshmërisë së aplikantve, projektet (lloji dhe kohëzgjatja) dhe kostot (përfshirë këtu kategoritë e kostove dhe shumën maksimale).

Faza 2: Vlerësimi dhe përzgjedhja e përkohshme e projekt-propozimeve.

Projekt-propozimet do të vlerësohen në përputhje me tabelen e përcaktuar të vlerësimit të paraqitur më poshtë.

Aplikantët kryesorë do të njoftohen me shkrim për vendimin mbi aplikimin e tyre dhe, nëse skualifikohen, arsytet për vendimin negativ. Vendimi gjithashtu do të përfshijë edhe listën e dokumenteve shoqëruese që duhen dorëzuar shtesë si edhe afatin përfundimtar për të dorëzuar këto dokumente me qëllim firmosjen e kontratës së grantit. Mos dorëzimi i dokumenteve shoqërues të kërkuara brenda afatit të caktuar mund të çojë në skualifikimin e aplikimit.

Çdo aplikim i skualifikuar do të zëvendësohet nga aplikimi i rradhës i renditur më mirë në listën rezervë dhe që është brenda buxhetit në dispozicion. Një aplikant që beson se është dëmtuar nga një gabim apo parregullsi gjatë procesit të vlerësimit mund të paraqesë një ankesë.

Kriteret e vlerësimit të përqëndrohen si në kapacitetin operacional dhe financiar të aplikantit (ve) ashtu edhe në cilësinë e aplikimeve në lidhje me rëndësinë e Projektit, përputhshmërinë e tij me synimet e thirrjes për aplikime, cilësinë, impaktin e pritshëm, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin.

Vlerësimi:

Tabela e vlerësimit është e ndarë në seksione dhe nënseksione. Secilit nënseksion do t'i vendoset një vlerë nga 1 deri në 5 si vijon: 1 = shumë i dobët; 2 = i dobët; 3 = i përshtatshëm; 4 = i mirë; 5 = shumë i mirë.

Tabela e Vlerësimit

Seksioni	Pikët Maksimale	Referenca në Formularin e Aplikimit
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	5	
1.1 Ka aplikanti (t) përvojën e kërkuar në menaxhim projekti dhe zbatim të prokurimit publik?	5	2.2.8
2. Rëndësia e Projektit	20	
2.1 Sa rëndësi ka propozimi për objektivat e thirrjes për aplikime?	5	2.2.1
2.2 Sa rëndësi ka propozimi ndaj nevojave dhe problematikave specifike lokale (duke përfshirë sinergjinë me iniciativat e tjera në zbatim dhe shmangia e mbivendosjeve)? Sa qartë dhe në mënyrë sasiore janë të përcaktuar përfituesit përfundimtarë të Projektit? Janë përcaktuar qartësisht nevojat e tyre dhe a i adreson propozimi ato në mënyrën e duhur?	10 (5*2)	2.2.1
2.3 A përmban propozimi elemente specifike me vlerë të shtuar, të tilla si çështje mjedisore, promovimin e barazisë gjinore dhe shanseve të barabarta, nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara, të drejtat e minoriteteve dhe praktikatat më të mira?	5	2.2.1
3. Efektshmëria dhe realizimi i Projektit	40	
3.1 A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme?	5	2.2.2
3.2 A është plani i aktiviteteve i qartë, realist dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të Projektit?	5	2.2.3
3.3 A është realist Plani Prokurimit dhe a është ai i plotësuar me dizajnin teknik/ termat e referencës dhe /ose specififikimet teknike që demonstrojnë gatishmërinë/maturitetin për realizimin e Projektit?	20 (5*4)	2.2.4
3.4 A përmban propozimi indikatorë (tregues) objektivisht të verifikueshëm për rezultatin e Projektit?	5	2.2.6
3.5 Është niveli i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së bashkë-aplikantit (ve) i shpjeguar qartësisht në Projekt?	5	2.2.2, 2.2.3
4. Ndikimi dhe Qëndrueshmëria e Projektit	10	
4.1 A ka Projekti ndikim të prekshëm për përfituesit përfundimtarë? A ka mund të kete projekt propozimi efekte të shumfajshme? (përfshirë qëllimin për përsëritje, zgjatje dhe shpërndarje të informacionit.)	5	2.2.5
4.2 A janë të qëndrueshme rezultatet e pritshme të Projektit të propozuar? - financiarisht (si do të financohen aktivitetet pasi të përfundojë financimi?) - institucionalisht (a do të jenë të pranishme në fund të Projektit strukturat që do të lejojnë vazhdimin e aktiviteteve? Do të ketë një "pronësi" lokale të rezultateve të Projektit?) - ambientalisht (nëse është e aplikueshme) do të ketë Projekti një ndikim mjedisor negativ / pozitiv?	5	2.2.5

Seksioni	Pikët Maksimale	Referenca në Formularin e Aplikimit
5. Buxheti dhe efiçenca e Projektit	25	
5.1 A janë aktivitetet të pasqyruara në mënyrën e duhur në buxhet?	5	2.2.7
5.2 A janë të nevojshme dhe plotësisht të justifikuara kostot për zbatimin e Projektit?	5	2.2.7
5.3 Janë kostot të vlerësuara në mënyrë të detajuar dhe në linjë me çmimet e tregut, për shembull, përmes studimit të tregut ose burimeve të tjera të tilla si interneti për koston e informacionit, përfshirë kontratat e mëparshme nga Bashkia?	15 (5*3)	2.2.7
Totali i pikëve maksimale	100	

Nëse aplikanti kryesor aplikon pa bashkë-aplikantin, pikësimi për pikën 3.5 do të jetë 5.

Përzgjedhja e përkohshme

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku do të listohen aplikimet e renditura në përputhje me pikët e tyre. Aplikimet që kanë marrë pikët më të larta do të përzgjidhen përkohësisht derisa të përdoret buxheti në dispozicion për këtë thirrje për aplikime.

Në rastin e aplikimeve me të njëjtat pikë, përparësi në listë do t'u jepet aplikimeve që kanë marrë më shumë pikë në seksionin 3 të Tabelës së Vlerësimit më lart, dhe në rast të pikëve të njëjta për seksionin 3, atyre që kanë marrë më shumë pikë në seksionin 5 të Tabelës së Vlerësimit, në rast të pikëve të njëjta për seksionet 3 dhe 5, përparësi do t'i jepet pikëve që janë dhënë në seksionin 2, më pas 4, më pas 1.

Përveç kësaj, një listë rezervë do të hartohet duke ndjekur të njëjtat kritere. Kjo listë do të përdoret nëse më shumë fonde do të vihen në dispozicion.

Çdo aplikim i skualifikuar do të zëvendësohet nga aplikimi pasues i renditur më mirë në listën rezervë që ndodhet brenda buxhetit në dispozicion për këtë thirrje për aplikime.

2.4 Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues

2.4.1 Përmbajtja e vendimit

Aplikantët kryesorë do të informohen me shkrim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues sa i përket aplikimit të tyre dhe, nëse skualifikohet, arsyet e vendimmarrjes negative.

Një aplikant që beson së është dëmtuar nga një gabim apo parregullsi gjatë procesit të akordimit të grantit mund të një paraqesë një ankesë.

Vendimi do të përfshijë gjithashtu listën e dokumenteve shoqëruese shtesë që duhen mundësuar me qëllim nënshkrimin e kontratës së grantit, si dhe afatin përfundimtar për të dorëzuar këto dokumente. Mos dorëzimi brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues i dokumenteve shoqëruese shtesë mund të çojë në skualifikim të aplikimit.

2.4.2 Paraqitja e dokumenteve shoqëruese për aplikimet e përzgjedhura përkohësisht

Dokumentet shoqëruese të mëposhtme duhen dorëzuar nga aplikantët e përzgjedhur përkohësisht si një kusht për të vijuar me përgatitjen e kontratës së grantit:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak për të zbatuar Projektin për të cilin është akorduar granti i PZHRSH, me mandatimin e Kryebashkiakut për të nënshkruar kontratën e grantit;
- Për projektet e investimit, një konfirmim mbi pronësinë e pasurisë së paluajtshme ose prova të tjera dokumentimi që vërtetojnë të drejtën ligjore për të përdorur pronën përkatëse publike;
- Plani i prokurimit publik i përditësuar për projektin me draft-dosjet e tenderit bashkëlidhur;

Aplikantëve kryesorë u rekomandohet fuqimisht që të nisin përgatitjen e dokumenteve shoqëruese menjëherë pas dorëzimit të aplikimit të tyre, kështu që këto dokumente të jenë në dispozicion datën e njoftimit të akordimit të grantit.

Dokumentet shoqëruese duhen dorëzuar në formën e origjinalit, apo varianteve të certifikuara të fotokopjeve apo të skanuara (dmth. të shfaqin të lexueshme qartësisht vultat, firmat dhe datat) të origjinaleve të përmendura më sipër.

Nëse dokumentet shoqëruese të përmendura më sipër nuk dorëzohen përpara afatit të shënuar në kërkesën për dokumentet shoqëruese të dërguara aplikantit kryesor nga Autoriteti Kontraktues, aplikimi mund të skualifikohet.

2.5 Afate indikative

	DATA	KOHA
1. Lançimi dhe publikimi i Thirrjes për Aplikime	20 Korrik 2020	
2. Informacion dhe sqarimet	29 Korrik 2020	
3. Udhëzime për aplikantët mbi përgatitjen e projekt-propozimeve	17 Gusht – 4 Shtator	17.08 – Bashkia Shijak; 19.08 – Bashkia Rrogozhinë; 21.08 – Bashkia Durrës; 24.08 – Bashkia Mirditë 25.08 – Bashkia Kavajë; 26.08 – Bashkia Vorë; 28.08 – Bashkia Kamëz; 31.08 – Bashkia Krujë 01.09 – Bashkia Kurbin; 02.09 – Bashkia Lezhë; 04.09 – Bashkia Tiranë Datat do të rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës.
4. Afati përfundimtar për të kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues	19 Gusht 2020	23.59
5. Data e fundit në të cilën jepen sqarimet nga Autoriteti Kontraktues	26 Gusht 2020	

6. Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve	21 Shtator 2020	16.00
7. Kërkesa(t) e sqarimeve me aplikantët kryesorë mbi vlerësimin e aplikimit	22 Shtator – 9 Tetor	
8. Njoftimi i vendimit për akordimin e grantit	28 Tetor – 20 Nëntor	
9. Firmosja e kontratës	9 – 27 Nëntor	

Të gjithë oraret janë sipas zonës kohore të Shqipërisë.

Këto afate indikative i referohen datave të përkohshme (përveç datave 1, 2, 4, 5 dhe 6) dhe mund të përditësohet nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës. Në raste të tilla, afatet e përditësuara do të publikohen në faqen e internetit të PZHRSH www.rdpa.al dhe faqen e internetit të FSHZH www.albaniandf.org.

2.6 Firmosja e kontratës së Grantit

Firmosja e kontratës së grantit parashikohet maksimalisht brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të akordimit të grantit Si rrjedhojë, pas marrjes dhe verifikimit të dokumenteve shoqërues, Autoriteti Kontraktues do të përgatisë kontratën e grantit dhe t'ia dërgojë atë aplikantit të përzgjedhur. Aplikanti i përzgjedhur do të firmosë kontratën dhe do t'ia dërgojë sërish Autoritetit Kontraktues, brenda afatit të përcaktuar.

2.7 Kushtet e zbatimit pas vendimit të Autoritetit Kontraktues për akordimin e një granti

Në vijim të vendimit për të akorduar një grant, përfituesit (esve) do t'i(u) ofrohet një kontratë granti e panegociueshme. Aplikimi i dorëzuar nga aplikanti, përfshirë ndonjë modifikim të kërkuar nga Komisioni i Vlerësimit, do të jetë shtojcë në kontratën e grantit.

Aty ku zbatimi i Projektit kërkon që përfituesit (ve) të lidhin kontrata prokurimi, ato kontrata duhen lidhur në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi.

3 LISTA E SHTOJCAVE

DOKUMENTET QË DUHEN PLOTËSUAR

- Shtojca A: Formulari i Aplikimit për Grantin (në formatin Word) – kjo dhe Shtojca A1 do të jenë Shtojca I për Kontratën e Grantit
- Shtojca A1: Kuadri Logjik (në formatin Word)
- Shtojca B: Buxheti (në formatin Excel) – kjo do të jetë Shtojca II për Kontratën e Grantit

DOKUMENTE TË TJERA

Kontratë Granti Tip